

VENDIM
Nr. 36, datë 1.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

me sekretare gjyqësore admira babaj në datën 27.01.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 58, 61 / 26 akti, që i përket:

KËRKUES: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuar në gjykim nga zonja Marsida Xhaferllari dhe zoti Vildan Kaloshi.

SUBJEKT I INTERESUAR: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga zoti Alban Brati.

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj”; shfuqizimi i vendimit të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e raportit të komisionit hetimor të ngritur me vendimin nr. 70/2014 Për hetimin e kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi”; shfuqizimi i vendimit të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj”.

Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të tri vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të datës 23.10.2014, të kundërshtuara për konflikt kompetencash kushtetuese, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për këtë kërkesë.

BAZA LIGJORE: Neni 134/1, shkronja “ç”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 56 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Besnik Imeraj, përfaqësuesit e kërkuës, që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë në datën 02.09.2014 ka miratuar vendimin nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa dhe zotit Lulzim Lelçaj”. Ky komision u ngrit për shqyrtimin e kërkesës së 39 deputetëve të mazhorancës “Për shkarkimin nga detyra të dy anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, Elvis Çefa dhe Lulzim Lelçaj, për shkelje të

rëndë të ligjit, bazuar në nenin 114 të Rregullores së Kuvendit”. Ky vendim i Kuvendit ka hyrë në fuqi në datën 18.09.2014, duke pasur në objekt të tij “...të verifikojë dhe të betojë zbatimin e ligjit mbi të dhënat, faktet dhe rrethanat e pretenduara, si dhe të konkludojë nëse ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e zotit Elvis Çefa dhe zotit Lulzim Lelçaj nga detyra e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi”.

2. Në datën 23.10.2014 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka bërë miratimin e raportit të komisionit hetimor të ngritur me vendimin nr. 70/2014. Në datën 23.10.2014 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka vendosur “Shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së Elvis Çefa dhe shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së Lulzim Lelçaj”.

3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 127, datë 06.10.2014, ka arritur në përfundimin se vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nuk përmban shkaqe për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së të parashikuara nga Kushtetuta, por bazohet në një shkak të ri të shtuar me ligjin nr. 101/2014, i cili është kundërshtuar tashmë në Gjykatën Kushtetuese.

4. Gjykata Kushtetuese e mbledhur në datë 24.11.2014 mori në shqyrtim paraprak kërkesën e KLD-së me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, shfuqizimin e vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe pezullimin e këtij vendimi si dhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për shkarkimin nga detyra të dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa dhe zotit Lulzim Lelçaj. Pasi shqyrtoi këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka konstatuar se kërkesat e paraqitura përmbajnë të njëjtin shkak dhe bazë ligjore, për këtë arsye vendosi të bëjë bashkimin e çështjeve me nr. K-14 të Regjistrit Themeltar dhe me nr. K-16 të Regjistrit Themeltar në një proces gjyqësor.

II

5. **Kërkesi** pretendon se vendimi nr. 70/2014 i Kuvendit të Republikës Shqipërisë objekt kundërshtimi ka krijuar një konflikt kompetence ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, duke parashtruar sa më poshtë:

5.1 Kuvendi ka marrë atributë që u përkasin organeve të tjera kushtetuese, siç janë KLD-ja dhe gjykata, duke u cenuar kështu parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

5.2 KLD-ja është organ kolegjal dhe çështjet e ngritura në kërkesë nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e anëtarëve të veçantë të KLD-së, por me vlerësimin e vendimarrjeve konkrete të saj për çështje konkrete.

5.3 Natyra e mandatit 5-vjeçar të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi tejkalon mandatin 4-vjeçar të Kuvendit që e ka zgjedhur.

5.4 Nisma për ndërprerjen e parakohshme të mandatit me anë të shkarkimit, është një nismë që nuk parashikohet në Kushtetutë, e rrjedhimisht është antikushtetuese.

5.5 Është cenuar parimi i sigurisë juridike. Komisioni hetimor për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së bazohet në ligjin nr. 101/2014, i cili ka hyrë në fuqi në datën 16 shtator 2014 dhe që është kundërshtuar nga KLD-ja në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë mënyrë i jepet fuqi prapavepruese ligjit nr. 101/2014 për fakte që kanë ndodhur përpara datës 16 shtator 2014.

5.6 Zbatimi i këtij vendimi mund të sjellë pasoja në standardet kushtetuese dhe mospezullimi i tij do të sillte vështirësi në ndreqjen dhe rekuperimin e veprimeve pas një vendimi eventual të Gjykatës që do ta shfuqizonte.

6. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në prapësimet e tij parashtron sa më poshtë:

6.1 Mungon legjitimiteti procedural i KLD-së për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet kërkesave objekt gjykimi.

6.2 Ligji i ri nr. 101/2014 është publikuar në Fletoren Zyrtare të datës 01.09.2014 dhe ka hyrë në fuqi në datën 16.09.2014, pra përpara datave që mbajnë dy vendimet e KLD-së.

6.3 Nuk mund të konsiderohet se ka një vendimarrje, në kushtet kur në veprimtarinë e një organi

kolegjal, sikundër është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk është thirrur një mbledhje, nuk ka pasur një rend dite, nuk ka pasur një procesverbal, si dhe nuk ka pasur mundësi që të gjithë anëtarët të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë në lidhje me këtë vendimmarrje.

6.4 Mungon legjitimiteti substancial i KLD-së për t'i kërkuar Gjykatës Kushtetuese zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, si edhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi.

6.5 Anëtarët e KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi duhet të shkarkohen nëse gjatë ushtrimit të mandatit të tyre shkelin Kushtetutën dhe ligjin.

6.6 Shqyrtimi i ligshmërisë dhe themelësisë së vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi është një çështje që i takon juridiksionit të pushtetit gjyqësor.

6.7 Kuvendi, në marrjen e vendimeve të tij për shkarkimin nga detyra të dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, u ka atribuuar vetëm fakte që buronin prej detyrimeve ligjore që ishin në fuqi, në kohën kur ata ushtronin funksionet e tyre publike. Rrjedhimisht, ky pretendim i kërkuesit është i papabazuar edhe në themelin e tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

7. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka pretenduar se KLD-së i mungon legjitimiteti substancial për t'i kërkuar Gjykatës Kushtetuese zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, si edhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi.

8. Sipas kërkuesit, Këshilli i Lartë të Drejtësisë, cenimi i kompetencave krijon interesin e ligjshëm kushtetues për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë në bazë të nenit 131/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

9. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate, zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve është trajtuar në disa vendime. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin e saj se dispozita e shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore, por edhe ato që mund të lindin ndërmjet organeve ose subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike, në secilin prej këtyre pushteteve.

10. Gjykata ripohon qëndrimin e saj se që të lindë një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë këto kushte të nevojshme: mosmarrëveshja, si rregull, të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme; mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve kompetente që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin; mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave të përcaktuara nga normat kushtetuese për pushtete të ndryshme, (*shih vendimet nr. 26/2006, nr. 29/2006, nr. 20/2007; nr. 54, datë 05.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin në shqyrtim Kuvendi ka marrë vendimin nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, vendimet e datës 23.10.2014, që lidhen me miratimin e këtij raporti, si dhe me shkarkimet e dy anëtarëve të KLD-së, me të cilat e ka konsideruar veten kompetent për të kontrolluar e vlerësuar veprimtarinë e organit të KLD-së. KLD-ja ka pretenduar se kjo është sferë e kompetencave të saj dhe ka kërkuar zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje në Gjykatën Kushtetuese.

12. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se KLD-ja, si organ kushtetues që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë, konsiderohet e legjitimuar për të qenë palë në një mosmarrëveshje pushtetesh.

13. Kuvendi pretendon se KLD-ja nuk legjitimohej proceduralisht për t'iu drejtuar Gjykatës

Kushtetuese, pasi vendimi nuk ishte firmosur nga të gjithë anëtarët dhe është bazuar në një vendim qarkullues.

14. Gjykata Kushtetuese vlerëson se KLD-ja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, përderisa kërkesa është firmosur në mënyrë të rregullt nga Presidenti i Republikës, që është njëkohësisht edhe Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Për këtë arsye, Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e Kuvendit të Shqipërisë.¹

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 70/2014 dhe tri vendimeve të Kuvendit të datës 23.10.2014

15. Kërkuesi ka kërkuar pezullimin e zbatimit të vendimeve objekt shqyrtimi, me pretendimin se zbatimi i këtyre vendimeve mund të sjellë pasoja në parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke pasuar më tej me cenimin e interesave shtetërore e deri te cenimi i interesave të individëve, si dhe me mirëfunksionimin e KLD-së.

16. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e zhvilluar në datat 05.11.2014 dhe 24.11.2014, ka marrë në shqyrtim kërkesat për pezullimin e këtyre vendimeve në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Sipas nenit 45 të ligjit të mësipërm, subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë prekjën e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vëren se nuk shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 dhe për këtë arsye vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim.

17. Gjithashtu, dy ish-anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Elvis Çefa dhe Lulzim Lelçaj, kanë paraqitur kërkesë për të marrë pjesë në cilësinë e subjektit të interesuar në gjykim, meqenëse ka lidhje të drejtpërdrejtë me interesat e tyre dhe, sipas tyre, argumente që ata do të paraqesin ndihmojnë në procesin e gjykimit, meqenëse kanë qenë anëtarë të KLD-së dhe vendimi është marrë në kohën kur ata kanë ushtruar detyrën e anëtarit.

18. Para fillimit të seancës, Gjykata, lidhur me kërkesën e paraqitur, vendosi mospranimin e kërkesës së zotit Lulzim Lelçaj dhe zotit Elvis Cefa për të marrë pjesë si subjekte të interesuara në këtë proces, pasi çështja që shqyrtohet është konflikt kompetencash ndërmjet dy institucioneve, prandaj nuk legjitimohen si subjekte të interesuara në këtë proces.

C. Në lidhje me pretendimin për mosmarrëveshjen e kompetencës

19. Kërkuesi pretendon se veprimtaria e komisionit hetimor parlamentar, e materializuar në raportin e tij, miratuar nga Kuvendi me vendimin e datës 23.10.2014, përbën një tejkalim kushtetues të funksioneve të Kuvendit në shkelje të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sepse ka ndërhyrë në kompetencat kushtetuese të organeve të tjera kushtetuese, respektivisht të KLD-së dhe të gjykatave, duke passjellë mosmarrëveshjen e kompetencave.

20. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuesi nuk është në gjendje të evidentojë kompetencën kushtetuese që i është marrë nga Kuvendi i Shqipërisë.

21. Një mosmarrëveshje kompetence, që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese, duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar të papajtueshëm me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes.

22. Gjykata konstaton se në ato raste kur Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim kërkesa për mosmarrëveshje kompetencash, ajo ka vlerësuar të nevojshme të analizojë kuptimin e standardeve kushtetuese, si edhe pozitën kushtetuese në strukturën institucionale shtetërore të organit që pretendon

¹ Gjyqtarët S. Berberi dhe F. Hoxha votuan për moslegjitimimin e kërkuesit në aspektin procedural, për arsye se nuk ka një vendimarrje të KLD-së, për të iniciuar gjykimin kushtetues, në përputhje me kriteret ligjore.

mosmarrëveshjen, duke u ndalur veçanërisht në kompetencat kushtetuese e ligjore të atij organi, si dhe në ballafaqimin e këtyre kompetencave me ato të organit që pretendohet se ka marrë kompetencën, duke shkaktuar, për rrjedhojë, lindjen e mosmarrëveshjes.

23. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Ky parim do të thotë se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur, dhe duhet të ketë një balancë midis tyre. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket ky institucion, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, si dhe nga raportet e kompetencave të tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Kushtetuta në nenin 147 parashikon se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, përgjegjësinë disiplinore sipas ligjit dhe shkarkimin e tyre. Nga ana tjetër, ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se KLD-ja është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të gjykatave të apelit (neni 1). KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e saj (neni 18).

25. Detyrat e KLD-së konkretisht përfshijnë: a) I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve. ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve. dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit, si dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre. e) Emëron dhe shkarkon kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. ë) Emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

26. Jurisprudenca kushtetuese e ka përkufizuar KLD-në si organin kushtetues të pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, KLD-ja përbëhet në shumicën e saj nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Frymën e korporatës (vetëqeverisjes) në KLD, kushtetutëbërësi e ka futur me qëllim të caktuar për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit (*shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Sipas jurisprudencës kushtetuese, mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “normativ”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “individual”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cili organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimin nr. 4 datë 02.02. 2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se në cilat kompetenca të tij është cenuar apo është penguar të ushtrojë funksionin e tij si pasojë e miratimit të

vendimeve objekt shqyrtimi. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi”, si dhe vendimet e datës 23.10.2014, që lidhen me miratimin e këtij raporti dhe me shkarkimet e dy anëtarëve të KLD-së, kanë cenuar kompetencat e KLD-së dhe gjykatave, por nuk ka arritur të provojë se në ç’mënyrë dhe në çfarë cilësie vetë kërkuesi i ushtron të tilla kompetenca. Vetë kërkuesi nuk rezulton që të jetë kompetent për çështje që lidhen me shkarkimin dhe emërimin e anëtarëve të KLD-së. Në bazë të nenit 147 të Kushtetutës, KLD-ja është kompetente për transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, ku përfshihet edhe shkarkimi i tyre. Pra, vetëm në lidhje me këto çështje KLD-ja konsiderohet se deklaron përfundimisht vullnetin e pushtetit gjyqësor.

29. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash, pasi nuk ekziston mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit.

Ç. Në lidhje me pretendimin e shfuqizimit të vendimeve të datës 23.10.2014 për shkarkimin e dy anëtarëve të KLD-së

30. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet nr.79, datë 23.10.2014 “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa” dhe nr. 80, datë 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Lulzim Lelçaj” janë antikushtetuese dhe kanë krijuar një konflikt me kompetencat.

31. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka parashtruar se shqyrtimi i ligjshmërisë dhe themelësisë së vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendit është një çështje që i takon juridiksionit të pushtetit gjyqësor.

32. Gjykata çmon se neni 131/c i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata thekson se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor.

33. Duke analizuar vendimin nr.79 të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa” dhe vendimin nr.80 të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa” dhe vendimin nr. 80 të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Lulzim Lelçaj”, Gjykata çmon se *strictu sensu* këto vendime u drejtohen palëve (dy anëtarëve të KLD-së) si subjekte individualisht të përcaktuara. Gjithashtu, objekti i vendimit është konkret. Efekti i këtyre vendimeve është shkarkimi i anëtarëve të KLD-së, duke u dhënë këtyre vendimeve përmbajtjen e akteve me karakter individual.

34. Gjykata vlerëson se, pasi ka ardhur në përfundim se në çështjen që shqyrtohet nuk ka konflikt kompetencash ndërmjet dy institucioneve, bazuar në konsideratat e mësipërme, kërkuesi, KLD-ja, për këtë pjesë të kërimit (*ratione materiae*) nuk legjitimohet.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e paraqitura nga KLD-ja janë të pabazuara dhe si të tilla duhet të rrëzohen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç”, si dhe të neneve 54, 55, 56, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkesë Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD-ja), ndonëse ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, nuk pajtohemi me linjën e arsytimit të bërë prej saj, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel në lidhje me legjitimitimin e kërkesës.

2. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka pretenduar, ndër të tjera, se kërkesuesi i mungon legjitimitimi procedural për t'iu drejtuar Gjykatës dhe substancial për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave (*shih § 7 dhe 13 të vendimit*). Sipas tij në rastin konkret nuk mund të konsiderohet se ka një vendimmarrje, në kushtet kur në veprimtarinë e një organi kolegial, sikundër është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk është thirrur një mbledhje, nuk ka pasur një rend dite, nuk ka pasur një procesverbal, si dhe nuk ka pasur mundësi që të gjithë anëtarët të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë në lidhje me këtë vendimmarrje (*shih § 6.3 të vendimit*).

3. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 134 të Kushtetutës rezulton se KLD-ja nuk është përfshirë në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për iniciimin e gjykimit kushtetues. Bazuar në nenin 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore). Ashtu siç është shprehur edhe shumica, dispozita e nenit 131/ç të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore, por edhe ato që mund të lindin ndërmjet organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të përcaktuar e kategorike në secilin prej këtyre pushteteve.

4. Kjo dispozitë kushtetuese është detajuar në nenin 54 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti (pika 3) dhe se bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve përbën çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (pika 4). Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata vendos, sipas nenit 56 të po këtij ligji, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit (*shih vendimin nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në këtë kuptim vlerësojmë se KLD-ja, duke qenë njëri prej subjekteve në konflikt që pretendon ndërhyrjen nga ana e pushtetit ligjvënës në sferën e kompetencave që i përkasin ekskluzivisht atij, legjitimohet si subjekt për të iniciuar këtë gjykim kushtetues.

6. Çështja që shtrohet për diskutim dhe në të cilën nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, ka të bëjë me legjitimitimin formal në aspektin e tij procedural, për sa kohë që kërkesa është paraqitur në Gjykatë e nënshkruar vetëm nga Presidenti i Republikës, në bazë të një vendimi qarkullues të miratuar nga Kryetari dhe të firmosur nga 8 anëtarë të KLD-së. Shumica për këtë çështje është mjaftuar me vlerësimin se KLD-ja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, përderisa kërkesa është firmosur në mënyrë të rregullt nga Presidenti i Republikës, që është njëkohësisht edhe Kryetari i KLD-së (*shih § 14 të vendimit*).

7. Në bazë të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të

Drejtësisë”, i ndryshuar, Presidenti i Republikës është Kryetari i KLD-së dhe ai thërret dhe drejton mbledhjen e KLD-së dhe kujdeset për zbatimin e ligjit gjatë zhvillimit të mbledhjeve dhe për marrjen e vendimeve (neni 11). Sipas nenit 18 të po këtij ligji, KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e tij. Mbledhja e KLD-së është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 8 anëtarë (neni 23), kurse neni 26 parashikon se KLD-ja i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje.

8. Në komentet e paraqitura përpara Gjykatës kërkuesi ka pretenduar se në disa raste organizimi i mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të jetë i pamundur, për shkak të karakterit kolegjial të organit, dhe në këto raste është vijuar (është bërë praktikë) me procedimin me vendime qarkulluese. Sipas kërkuesit këto vendime, të cilat u dërgohen anëtarëve në pamundësi për të realizuar mbledhjen e këtij organi, në thelb respektojnë çdo procedurë të parashikuar në ligj, me përjashtimin të pranisë së anëtarit në mbledhjen përkatëse.

9. Në lidhje me vendimet qarkulluese çmojmë se ato janë vendime që nuk parashikohen nga ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 i ndryshuar (ligji organik i KLD-së). Në rastin konkret nuk rezulton të ketë pasur ndonjë situatë që e bënte të pamundur realizimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim miratimin e propozimit për dërgimin e kërkesës konkrete në Gjykatën Kushtetuese. Ligji organik i KLD-së parashikon se në rastin e mbledhjes së jashtëzakonshme KLD-ja mbledhet brenda 24 orëve². Rasti në shqyrtim jo vetëm që nuk lidhet me një prej situatave të parashikuara nga ligji organik i KLD-së për thirrjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme, por dhe pamundësia e mbledhjes së organit nuk justifikon miratimin e një vendimi qarkullues.

10. Gjatë seancës gjyqësore kërkuesit iu shtrua pyetja nëse ishin njoftuar të gjithë anëtarët e KLD-së për projektvendimin dhe nëse kishte një shënim në procesverbalin e mbledhjes për të vërtetuar vullnetin e të gjithë anëtarëve. Kërkuesi nuk arriti të argumentonte arsyet e pamundësisë së realizimit të mbledhjes, qoftë edhe të jashtëzakonshme, të organit kolegjial, si dhe situatën urgjente që ka çuar në miratimin e vendimit qarkullues në fjalë. Kërkuesi u angazhua se do të vendoste në dispozicion informacionin e kërkuar, gjë e cila nuk u realizua.

11. Bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, të ndryshuar, mbledhjet e KLD-së janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 8 anëtarë. Në rastin konkret vendimi qarkullues është firmosur nga 8 anëtarë, duke plotësuar kriterin e kuorumit të nevojshëm për thirrjen e mbledhjes. Megjithatë, kreu i tretë i ligjit organik të KLD-së parashikon edhe rregulla të tjera specifike që duhen ndjekur për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të KLD-së. Konkretisht, njoftimit për thirrjen e mbledhjes së Këshillit i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve për të cilat do të diskutohet në mbledhje (neni 20). Rendi i ditës u shpërndahet anëtarëve të KLD-së së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes (22). KLD-ja i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje (neni 26). Në procesverbal pasqyrohet data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, rendi i ditës, çështjet që janë diskutuar, diskutimet e pjesëmarrësve, propozimet e bëra, vendimet e marra, forma, rezultati dhe mënyra e votimit nga çdo anëtar (neni 27). Rregullat e parashikuara nga ligji organik për KLD-në janë në harmoni edhe me ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Në bazë të këtij ligji, në procesverbalin e mbledhjes së organit kolegjial shënohet fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga ky organ.

12. Në vështrim të këtyre dispozitave çmojmë se edhe në kushtet kur nuk ka një mbledhje formale duhet të plotësohen dy elemente, në mënyrë që të kemi një vendimmarrje legjitime të KLD-së: së pari, duhet që anëtarët të kenë mundësi të njoftohen dhe të njihen me çështjen që shtrihet për diskutim dhe, së dyti, të kenë mundësi të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me çështjen e shtruar për vendimmarrje. Respektimi i këtyre dy elementeve është i domosdoshëm, pasi kemi të bëjmë me vendimmarrjen e një organi që funksionon në mënyrë kolegjiale.

² Neni 21 i ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

13. Në rastin në shqyrtim vlerësojmë se nuk është respektuar procedura ligjore për thirrjen e mbledhjes së KLD-së dhe miratimin e vendimit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave. Për pasojë, në kushtet kur nuk është respektuar procedura për thirrjen e mbledhjes, nuk ka pasur një rend dite, nuk ka pasur një procesverbal të zhvillimit të mbledhjes, si dhe nuk ka pasur mundësi që të gjithë anëtarët të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë në lidhje me këtë vendimmarrje, nuk kemi një vendimmarrje të KLD-së.

14. KLD-ja si organ kolegjal në ushtrimin e veprimtarisë së saj është subjekt i kufizimeve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin organik të saj. Këto kufizime, të cilat janë në funksion të shtetit të së drejtës, mund të jenë të karakterit procedural ose substancial. Rregullimet kushtetuese dhe ligjore për procedurat vendimmarrëse të KLD-së dhe për shumicat e votave të kërkuara, i shërbejnë veçanërisht këtij qëllimi. Në vlerësimin tonë, ndjekja e praktikës procedurale me vendime qarkulluese nga ana e KLD-së rezulton të mos ketë bazë kushtetuese ose ligjore, ndaj kjo sjellje institucionale e këtij organi kolegjal e kthyer në praktikë bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës).

15. Parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore (*shih vendimet nr. 15, datë 15.04.2010 dhe nr. 14, datë 21.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa më sipër, duke qenë se çështja e legjitimitetit të subjektit, që vë në lëvizje Gjykatën, është një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një gjykimi kushtetues, bazuar në argumentet e mësipërme, vlerësojmë se Gjykata duhet të ishte ndalur në çështjen e legjitimitetit të kërkuarit në aspektin procedural dhe në përfundim duhet të kishte vendosur mospranimin e kërkesës në kushtet kur nuk ka pasur një vendimmarrje nga ana e KLD-së.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

MENDIM I PAKICËS

1. Nuk jam dakord me vendimmarrjen e shumicës për rrëzimin e pretendimeve të kërkuarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD-ja), për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet tij dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), të krijuar për shkak të vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Leļaj” si dhe të 3 vendimeve të datës 23.10.2014 të Kuvendit “Për miratimin e raportit të komisionit hetimor të ngritur me vendimin nr. 70/2014 “Për hetimin e kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi”; “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa”; “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, z. Lulzim Leļaj”.

2. Shumica, pasi ka vlerësuar se KLD-ja si organ kushtetues që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë konsiderohet e legjitimuar për të qenë palë në një mosmarrëveshje pushtetesh (shih paragrafin nr. 12 të vendimit), ka arritur në përfundimin se kërkuari nuk ka arritur të argumentojë se në cilat kompetenca të tij është cenuar apo është penguar të ushtrojë funksionin e tij. Sipas shumicës, kërkuari ka pretenduar se vendimi nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi”, si dhe vendimet e datës 23.10.2014, që lidhen me miratimin e këtij raporti dhe me shkarkimet e dy anëtarëve të KLD-së, kanë cenuar kompetencat e KLD-së dhe të gjykatave, por nuk ka arritur të provojë se në ç' mënyrë dhe në çfarë cilësie vetë kërkuari i ushtron të tilla kompetenca. Vetë kërkuari nuk rezulton të jetë kompetent për çështje që lidhen me shkarkimin dhe emërimin e anëtarëve të KLD-së. Në bazë të

nenit 147 të Kushtetutës, KLD-ja është kompetente për transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, ku përfshihet edhe shkarkimi i tyre. Pra, vetëm në lidhje me këto çështje KLD-ja konsiderohet se deklaron përfundimisht vullnetin e pushtetit gjyqësor (*shih paragrafin nr. 28 të vendimit*). Në këto kushte, shumica ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, pasi në rastin në shqyrtim nuk ekziston mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit (*shih paragrafin nr. 29 të vendimit*).

3. Për sa u përket vendimeve të datës 23.10.2014 të Kuvendit “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa” dhe “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Lulzim Lelçaj”, shumica ka çmuar se *strictu sensu* këto vendime u drejtohen palëve (dy anëtarëve të KLD-së) si subjekte individualisht të përcaktuara dhe se objekti i vendimit është konkret. Efekti i këtyre vendimeve është shkarkimi i anëtarëve të KLD-së, duke u dhënë këtyre vendimeve përmbajtjen e akteve me karakter individual (*shih paragrafin nr. 33 të vendimit*). Për pasojë, sipas shumicës, kërkuesi, KLD-ja, edhe për këtë pjesë të kërimit (*ratione materiae*) nuk legjitimohet (*shih paragrafin nr. 34 të vendimit*).

4. Arsyetimi i mësipërm i shumicës përveçse konfuz, bie ndesh me jurisprudencën e kësaj Gjykate. Sipas doktrinės kushtetuese që të kemi konflikt kompetencash midis pushteteve duhet të përmbushen tri kritere:

- a) mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme;
- b) mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin;
- c) mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave.

5. Gjykata e ka elaboruar më tej konceptin e mosmarrëveshjes së kompetencës duke theksuar se mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë mbi këtë bazë aktin individual të zbatimit. Në praktikë një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimet nr. 48, datë 08.11.2011; nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata ka vërejtur, gjithashtu, se konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk e kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij apo e kanë penguar në ushtrimin e tyre. Pavarësisht nga shprehja ose jo e kundërshtimeve për përkatësinë e pushtetit, mund të konsiderohet se konflikti është i pranueshëm për t’u gjykuar edhe në rast se nga ushtrimi abuziv i pushtetit pakësohet ose pengohet ushtrimi i kompetencave që Kushtetuta ia atribuon subjektit ankues (*shih vendimin nr. 48, datë 08.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Përveç sa më lart, çështja e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave për shkak të ngritjes (ose jo) të komisioneve hetimore nga ana e Kuvendit ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë edhe në raste të tjera, në të cilat ajo në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur parasysh funksionin kushtetues të Kuvendit (nëpërmjet komisioneve hetimore të tij), si dhe pozicionin e subjektit tjetër kushtetues në konflikt, KLD-ja në rastin në shqyrtim, në strukturën e organeve të shtetit.

8. Gjykata në shqyrtimin e funksionit kushtetues të Kuvendit dhe të rolit të komisionit parlamentar hetimor në këtë drejtim ka marrë parasysh faktin se Kushtetuta nuk i njeh epërsi një pushteti ose organi kushtetues në raport me pushtetet e tjera të shtetit. Demokracia kushtetuese e vendosur me Kushtetutë bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kuvendi është njëri nga organet e autoritetit të shtetit.

Kompetencat e tij dhe për pasojë sfera e veprimtarisë së tij është e përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje. Kuvendi gëzon, brenda limiteve të parashikuara në Kushtetutë, një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien. Brenda kësaj sfere, shkalla e autonomisë së Kuvendit është më e madhe se në sfera të tjera të kompetencave të tij, për shkak të faktit se ai është organi ligjvënës i shtetit. Kushtetuta e ngarkon Kuvendin edhe me funksion kontrollues, me synimin për të realizuar balancën midis pushteteve. Në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. Në këtë kuptim, funksioni i kontrollit parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit ligjvënës për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta. Kjo vlen edhe për komisionet hetimore, objekti i veprimtarisë të së cilave, i përcaktuar në vendimet e ngritjes së tyre, është objekt i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimet nr. 19, datë 03.05.2007; nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Detyra që i ngarkohet një komisioni hetimor parlamentar nuk mund të jetë e tillë që të çojë në shkeljen e rregullimeve kushtetuese që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me organet, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit që ushtron Kuvendi. Kufijtë e veprimtarisë së një komisioni hetimor janë specifikuar nga limitet kushtetuese për kontrollin e Kuvendit. Veprimtaria e një komisioni hetimor nuk duhet as të zëvendësojë, as të marrë kompetencat e organeve të cilat në bazë të Kushtetutës janë të detyruara ta realizojnë këtë kompetencë. Gjykata është shprehur se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, si parimin e ndarjes së pushteteve, të prezumimit të pafajësisë etj. (*shih vendimet nr. 26, datë 04.12.2006; nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Një hetim i iniciuar, që nuk lidhet me qëllimet dhe që nuk i përket veprimtarisë së ligjvënësit dhe rolit kontrollues brenda kufijve të trajtuar më sipër, nuk konsiderohet në përputhje me parimet kushtetuese. Komisioni hetimor, duke hetuar një fushë të caktuar brenda kompetencave që përfshihen në përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit, mund të arrijë të gjejë të dhëna të cilat përbëjnë shkak për t'u vlerësuar nga ana e tij, por pa hyrë në sferën e organeve hetimore e gjyqësore të ngarkuara nga Kushtetuta për veprimtari të këtij lloji (*shih vendimet nr. 26, datë 04.12.2006; nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se Kuvendi mund të ushtrojë hetim nëpërmjet komisioneve të tij edhe mbi zyrtarët e institucioneve kushtetuese për çështje të veçanta, të cilat përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që lejohen nga Kushtetuta, por një hetim i tillë nuk mund të zëvendësojë apo të dublojë prerogativat e organeve të tjera të pavarura (*shih vendimin nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, Gjykata është shprehur se kur Kuvendi ngre një komision hetimor, duhet të respektojë parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, përndryshe mund të krijohen premisa për lindjen e një konflikti kompetencash.

11. Për sa i përket pozicionit kushtetues të organit të KLD-së, Kushtetuta në nenin 147 parashikon se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, përgjegjësinë disiplinore sipas ligjit dhe shkarkimin e tyre. Nga ana tjetër, ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar parashikon se KLD-ja është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të gjykatave të apelit (neni 1). KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e saj (neni 18).

12. Detyrat e KLD-së konkretisht përfshijnë: a) I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve. ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve. dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e

vlerësimi, si dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre. e) Emëron dhe shkarkon kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. ë) Emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

13. Jurisprudenca kushtetuese e ka përkufizuar KLD-në si organin kushtetues të pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. KLD-ja përbëhet në shumicën e saj nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Frymën e korporatës (vetëqeverisjes) në KLD kushtetutëbërësi e ka futur me qëllim të caktuar për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit (shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Nga sa më lart rezulton se KLD-ja është një organ administrativ i pavarur që realizon vetëqeverisjen e pushtetit gjyqësor. Bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizmin dhe funksionimin e KLD-së”, të ndryshuar, KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e tij.

15. Në rastin në shqyrtim objekti i hetimit të komisionit, i cili nuk mund të kuptohet i shkëputur nga çështjet që kanë gjetur pasqyrim në raportin e komisionit hetimor, konsiston: 1. Në shkeljen e standardit kushtetues të paanësisë (shkarkimi i z. Sokol Binaj dhe caktimi i z. Gjin Gjoni, anëtar i KLD-së, si anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, në shkelje të ligjit; emërimi i z. Neshat Fana si drejtor i Shkollës së Magjistraturës në shkelje të ligjit; zgjedhja e anëtarit të KLD-së, z. Ilir Mustafaj, si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë). 2. Në mosverifikimin e papajtueshmërisë së mandatit të anëtarit të KLD-së. 3. Në mosemërimin brenda afatit ligjor të magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitet 2012, 2013 dhe 2014. 4. Në marrjen nga KLD-ja të kompetencave të Shkollës së Magjistraturës në testimin seleksionues të kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat administrative. 5. Në marrjen nga KLD-ja të kompetencave të Ministrit të Drejtësisë për shpalljen e vendeve vakantë në gjykata, 6. Në mosemërimin e kryetarëve të 28 gjykatave në kundërshtim me ligjin. 7. Në emërimin e kryetarëve të gjykatave në kundërshtim me ligjin. 8. Në promovimin e gjyqtarëve në kundërshtim me ligjin. 9. Në keqorganizimin e sistemit gjyqësor. 10. Në mosmarrjen në shqyrtim të kërkesave të ish-Kryetares së Gjykatës të Lartë dhe ish-Prokurores së Përgjithshme. 11. Në emërimin e z. Arjan Balliu si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

16. Bazuar në rezultatet e hetimit parlamentar vërehet se edhe pse objekti i këtij hetimi ka pasur si qëllim verifikimin dhe hetimin për zbatimin e ligjit nga ana e dy anëtarëve të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, komisioni hetimor i ngritur ka marrë në shqyrtim vendimet e KLD-së të marra si organ kolegjial. Pra, veprimtaria e komisionit hetimor nuk është ndalur në veprime apo mosveprime antiligjore apo antikushtetuese të kryera individualisht nga 2 anëtarët e KLD-së, z. Elvis Çefaj dhe z. Lulzim Lelçaj, por në thelb ka vënë në pikëpyetje vendimmarrjen e një organi kolegjial të pavarur, siç është KLD-ja, pjesë e të cilës kanë qenë edhe anëtarët në fjalë, duke cenuar rëndë pavarësinë e këtij organi kushtetues. Për rrjedhojë, komisioni hetimor ka kryer një veprimtari që nuk hyn në sferën e tij të kompetencave, duke krijuar, për rrjedhojë, një konflikt kompetencash midis pushtetit legjislativ dhe atij gjyqësor.

17. Gjykata ka theksuar se hetimi parlamentar, në interpretim të nenit 77 të Kushtetutës, që sanksionon veprimtarinë e komisioneve hetimore të Kuvendit, nuk mund të jetë absolutisht i pakufizuar. Ky kufizim imponon që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, që hetimi parlamentar të lidhet me veprimtarinë e ligjvënësit dhe që hetimi të mos përdoret (si në rastin konkret) në mënyrë abuzive (shih vendimin nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Si përfundim, në rastin konkret jam i mendimit se kërkesa e KLD-së duhej pranuar.

Anëtar: Vladimir Kristo